



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi

VENDIM

Nr. 256, datë 17.12.2018

PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALKGAZ” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, *”Për Sektorin e Energjisë Elektrike”*, i ndryshuar; nenit 22, pika 2, gërma “ç”; nenit 83 të Ligjit Nr. 102/2015 *“Për Sektorin e Gazit Natyror”*; si dhe nenit 4, pika 1, gërma “ç”; neneve 5; 8, 9 dhe nenet 11 dhe 12 të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e Gazit Natyror”*; miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017; nenit 15 të *“Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”*, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, lidhur me licencimin e shoqërisë “BALKGAZ” sh.p.k, në veprimtarine e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë),

Konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 704 Prot, datë 05.11.2018, shoqëria “BALKGAZ” sh.p.k, ka aplikuar në ERE për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).
- Bordi i ERE me vendimin nr. 241, datë 15.11.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u publikua në media njoftimi me nr. 55/70 Prot., datë 19.11.2018 në lidhje me fillimin e kësaj procedure. Po ashtu me shkresën nr. 704/2 Prot., datë 21.11.2018, iu kërkua subjektit plotësimi i dokumentacionit të munguar.
- Subjekti me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 704/3, datë 03.12.2018, ka paraqitur pjesërisht plotësimin e dokumentacionit të munguar si dhe spjegimet përkatëse.

- Në mbledhjen e datës 11.12.2018, u shty relatimi i relacionit nr. 88/6 Prot., datë 06.12.2018, *“Mbi licencimin e shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë)”*, për të sqaruar me subjektin çështjet që prekin sasinë e gazit të parashikuar për tu tregtuar si dhe infrastrukturën me të cilën do operohet nga subjekti.
- Në vijim ERE më shkresën nr. 704/4 Prot., datë 11.12.2018, ftoi përfaqësuesit e Balkgaz sh.a për të marrë pjesë në seancën dëgjimore të datës 13.12.2018, për të diskutuar në lidhje me sa më sipër.
- Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesit e subjektit deklaruan se interesi kryesor i shoqërisë *“BALKGAZ” sh.p.k* është operimi në tregun shqiptar të gazit natyror dhe zbatimi i parashikimeve të Plan – Biznesit do varet nga koncepti i ngritjes së biznesit nga ky operator. Ata shprehën se janë të ndërgjegjshëm për mungesën e infrastrukturës në vend, por spjeguan se Plan – Biznesi është një parashikim për të ardhmen. Po ashtu ata deklaruan se e ardhmja do të varet edhe nga kontratat që do të nënshkruajnë pas disponimit të licencës nga ERE. Këto kontrata do të përmbajnë të dhëna konkrete për sasinë e gazit natyror që do të tregtohet, por kjo gjë mund të realizohet vetëm pas pajisjes me licencë nga ERE. Gjithashtu edhe për Garancinë e cilësisë së gazit natyror, sikurse është shprehur edhe më parë në korrespondencat e tij me ERE-n, subjekti deklaroi se do të jetë në gjendje ta përcjellë atë në ERE në momentin e kontraktimit me palët e treta. Subjekti tregoi gatishmëri të plotë për të depozituar në ERE përgjatë kohës kontratat që do të lidh dhe çdo dokument që do ti kërkohet.
- Nga analiza që i’u bë dokumentacionit të aplikimit të shoqërisë *“BALKGAZ” sh.p.k.*, si dhe dokumentacionit të përcjellë nga subjekti me anë të shkresave sipërcituar, në bazë të *“Rregullore për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licensave në sektorin e gazit natyror”*, rezulton si më poshtë:
 - **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:
 - Neni 9, pika 1, gërmat *“a“ ; “b” ; “c” ; “d”* , pikat *“i.” ; “ii” ; “iii”*, dhe *“iv”* .
Plotësuar.
 - **Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale**, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:
 - Neni 9, pika 1, gërma *“e”*, pikat *“i” ; “ii” ; “v” ; “vi” ; “vii”*. **Plotësuar;**

- **Dokumente Specifike për Llojin e Licencës**, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:
 - Neni 9, pika 2, gërma dhe “iii” **Plotësuar**;
- i. Nuk janë paraqitur nga subjekti **“Dokumente Specifike për Llojin e Licencës”**, Neni 9, pika 2, gërma “i” Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në Milion Nm3, e parashikuar për t'u livruar gjatë një viti. dhe “ii”, (Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të Sistemit).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “BALKGAZ” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë), për një afat 10 vjeçar.
2. Me fillimin e operimit të veprimtarisë së tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë), shoqëria të paraqesë në ERE sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në Milion Nm3, e parashikuar për t'u livruar gjatë një viti, si dhe Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të Operatorit të Sistemit
3. Në rastin e mospërmbushjes së këtij kushti nga ana e subjektit, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi
4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë të aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI